



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministerstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Ref. Nr. 244 / 2016
Data Datum Date 26.01.2016
Nënshkrimi Çmpos. Signature Adonaj Smajlaj
PRISHTINË, PRISHTINA, PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta – Ministry
of Culture, Youth and Sport

Këshilli Kombëtar Shqiptar
Albanski Nacionalni Savet
Albanian National Council

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Ky memorandum bashkëpunimi lidhet ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), e përfaqësuar nga Ministri, z. Kujtim SHALA, në njërin anë dhe Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH), në anën tjetër, i përfaqësuar nga z. Jonuz MUSLIU.

Neni 1 **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

Ky Memorandum lidhet me synimin e krijimit të bashkëpunimit në politikat, programet, nismat për aktivitetet kulturore dhe rinore, përmes përkrahjes për ngjarjet kulturore dhe rinore të komunitetit shqiptar në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Neni 2 **Palët Kontraktuese**

- 2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Prishtinë;
- 2.2. Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH), Bujanoc.

Neni 3 **Objektivat**

Palët pajtohen që të nxisin veprime të përbashkëta dhe të inkurajojnë bashkëpunimin në fusha me interes kulturor e rinor, përmes aktiviteteve si në vijim:

- 3.1. Përkrahja në zhvillimin, kultivimin dhe ruajtjen e identitetit dhe kulturës së shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc;
- 3.2. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve dhe manifestimeve kulturore, rinore dhe sportive;
- 3.3. Bashkëpunimi mes organizatave të kulturës, rinisë dhe shoqërisë civile, në mes të institucioneve ose organizmave të ngjashëm;
- 3.4. Shkëmbimi i përvojave në ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e kulturës dhe traditës;
- 3.5. Nxitja e krijimtarisë së përbashkët kulturore, artistike, rinore e letrare;
- 3.6. Përkrahja për ngritjen e kapaciteteve, për programet kulturore;
- 3.7. Përkrahje për përmirësimin e kushteve në institucionet kulturore ekzistuese;
- 3.8. Shtimit të numrit të organizimeve dhe manifestimeve kulturore kombëtare;
- 3.9. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe **KKSH-së** obligohen të angazhohen në rritjen e bashkëpunimit në nivel qendror sidomos në fushën e trashëgimisë kulturore nëpërmjet bashkëpunimeve konkrete;
- 3.10. Nxitja e bashkëpunimit në mes të përfaqësuesve kulturor të të tri qyteteve dhe më gjerë ku jetojnë shqiptarët me qëllim të zhvillimit më të gjerë të kulturës dhe bashkërendimit të aktiviteteve;
- 3.11. Organizimin e seminareve dhe simpoziumeve ndërkombëtare si dhe aktivitete tjera ndërkombëtare me qëllim të përfshirjes dhe promovimit të kulturës shqiptare.

Neni 4 Obligimet

4.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, obligohet që:

- 4.1.1 Të ofrojë asistencë rreth fondit të librave si dhe krijimit të një fondi të përbashkët për të furnizuar me libra në gjuhën shqipe, bibliotekat e tri qyteteve;
- 4.1.2. Të përkrahë KKSH-në, në afirmimin e vlerave kulturore në rrethin më të gjerë të bashkësisë shqiptare;
- 4.1.3. Të përkrahë mundësitë krijuese të krijuesve shqiptarë të qyteteve respektive, si dhe afirmimin e vlerave kulturore të cilat paraqesin të mirat e përhershme shpirtërore dhe përkrah projektet e përbashkëta Kulturore, Sportive dhe Rinore.

4.2. KKSH obligohet që:

- 4.2.1. Të sigurojë donacione për aktivitetet edhe angazhimet kulturore;
- 4.2.2. Të rritë aktivitetet e promovimit përmes pranisë dhe paraqitjes më të madhe të kulturës shqiptare në mesin e popullsisë shumicë.

Neni 8 Legjislacioni

Veprimet e parashikuara në këtë Memorandum do të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi të të dyja shteteve.

Neni 9 Hyrja në fuqi dhe nënshkrimet

Ky memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët respektive të përcaktuara në nenin 2 të këtij memorandum, përkatësisht Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar.

Kujtim SHALA,
Ministër

Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit



Jonuz MUSLIU,
Kryetar

Këshilli Kombëtar Shqiptar

Nënshkruar më 20 / 01 / 2016
Prishtinë